

Dita botërore e luftës kundër Tuberkulozit

24 Mars

Dita Botërore e Tuberkulozit mbahet çdo vit në [24 mars](#). Synimi i saj është që të promovojë ndërgjegjësimin, njohuritë dhe motivimin për të vepruar kundër tuberkulozit në mbarë botën. Ajo e ka origjinën në vitin 1882, kur u festua 100 vjetori i zbulimit të bacilit të TB-së nga Koch.

Organizata Botërore e Shëndetësisë thotë se rreth nëntë milion vetë në mbarë botën janë të prekur nga tuberkulozi ndërkohë që rreth 1, 8 milionë vdesin çdo vit. Pasojat më të rënda vërehen në Azinë e Jugut dhe të lindjes, ndjekur nga Afrika dhe rajonet e Paqesorit Perëndimor, duke kapur kështu rreth 85 përqind të numrit total në botë.

Te dhena epidemiologjike ne Shqiperi:

Ne saje te nderhyrjeve te bera nga sherbimet shendetesore, situata ne vend eshte permiresuar ndjeshem.

- Incidenca e rasteve te reja me TB per vitin 2007, ka qene 13/ 100.000 banore
- Rezistenca bakteriale dhe ajo ndaj barnave anti tuberkulare eshte < 2% ne shkalle vendi.
- Mortaliteti eshte i ulet, rreth 5/ 100.000 banore
- Mjekimi ka rezultat ne 87% te rasteve te reja me TB

Tuberkulozi eshte semundje infektive kronike e shkaktuar nga Mycobakteriuni tuberculosis, qe prek kryesisht mushkerite, por edhe organet e tjera si trurin, kocken, gjendrat limfatike, gjakun, zemren, lekuren etj...

Transmetohet nga kontakti direkt me piklat respiratore te nje personi zakonisht adult, te semure me formen pulmonare aktive te semundjes dhe pas kesaj duhet nje periudhe inkubacioni prej 2-10 javesh.

Shenjat jane te ndryshme sipas aparatit qe prek.

Trajtimi behet me ane te terapise se kombinuar te disa anti tuberkulareve per periudha kohore prej 6-9 muajsh ne format pulmonare dhe te pakten 1 vit ne format me te renda si meningiti dhe osteomieliti. Bakteria e tuberkulozit kalon ne mutacione dhe fiton rezistencë ndaj ilaçeve gjë që e bën më të vështirë kurimin sepse shumë pacientë nuk arrijnë të çojnë deri në fund kurat.

Parandalimi/profilaksia:

- detyrime ligjore: denoncimi i detyruar, izolim i pacientit deri ne negativizimin e sputumit, mbikeqyrje dhe kontrole te vazhdueshme te te semurit dhe te personave qe banojne me te.
- Vaksinimi antituberkular eshte i detyrueshem ne moshen femnore dhe aplikohet qe ne lindje.
- Kemio profilaksia antituberkulare behet me Isoniazid tek personat me reagim te reaksionit te tuberkulines (mantoux pozitive) ne mungese te shenjave klinike, apo te shoqeruara me ulje te imunitetit sic rasti HIV/AIDS etj

Strategjia e re kombetare per vitet 2009-2014, parashikon nje perqasje me agresive per kontrollin e TB dhe ka si objektiva specifike kryesore:

1. forcimin e sistemit shendetesor per kontrollin e TB dhe integrimi i ketij kontrolli **ne sherbimin paresor** brenda 5 viteve te ardhshme
2. sigurimi dhe **mbajtja e mbulimit 100% me DOTS** (strategjia e mjekimit standart nen mbikeqyrje per kohe te shkurter) ne shkalle vendi
3. sigurimi dhe **mbajtja e aksesit ndaj DOTS per grupet vulnerabel**
4. menaxhim me te mire te rasteve me rezistence bakteriale dhe medikale (MDR)